

## BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
\_\_\_\_/\_\_\_\_2019

Lezhë, më

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data :09.08.2019

Për: Bashkimin e Operatoreve ekonomik DriniA& Varaku -E shpk

**Procedura e prokurimit:** Kerkse per propozim me mjete elektronike

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-29331-07-04-2019

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Sistemim asfaltim i rrugeve te brendshme ne fshatin Tresh**

**Fondi limit :** 6 852 483 ( gjashtemilion e teteqind e pesedhejte e dy mije e katerqind e tetedhjte e tre ) leke pa t.v.sh , vene ne dispozicion nga buxheti i bashkise Lezhe ( te ardhurat ) miratuar me VKB nr. 25 , datë 29.01.2019 “Për Lënjen në fuqi të VKB-së nr 7 datë 28.01.2019 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2019 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”, VKB nr 31 date 29.03.2019 Per miratimin e prokurimit me vlere te plote te investimeve te parashikuara per vitin 2019 dhe PBA-se 2019-2021, dhe vendimit nr 175 date 21.05.2019 te Kryetarit te bashkise Per miratimin e ndryshimit te investimeve ku vlere e plote e ketij financimi u be 6 852 483 ( gjashtemilion e teteqind e pesedhejte e dy mije e katerqind e tetedhjte e tre ) leke pa t.v.sh , Per **Sistemim asfaltim i rrugeve te brendshme ne fshatin Tresh si dhe** dhe vendimit nr 223 date 06.06.2019 te Kryetarit te bashkise Per miratimin e ndryshimit te investimeve

Vlere e financimit per vitin 2019 do te jete ne shumen prej 2 166 667 leke pa perfshire vleftene tvsh-se, diferenca e financimit do te shtrihet ne vitin buxhetor 2020 dhen 2021

**Afati i perfundimit te punimeve:** 3 muaj ose 90 dite nga data e dorezimit te sheshit te ndertimit

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomik Drini A me nr Nipti J67902505V& Varaku shpk me nr Nipti J61902509S me vlere oferte 6 052 250 ( gjashte milion e pesedhjte e dy mije e dyqinde pesedhjte leke
2. Nika shpk nipt J76705047U me vlere oferte 4 651 534( katermilion e gjashteqind e pesedhjte e nje mije e peseqind e tridhjte e kater leke
3. Senka shpk K52531415H me vlere oferte 6 204 200 ( gjashtemilion e dyqind e kater mije e dyqind) leke

4. Sark shpk J94808405Q me vlere oferte 5 389 034( pesemilion e treqind e tetedhjetë e nente mijë e tridhjetë e kater ) leke

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1- Sark shpk J94808405Q me vlere oferte 5 389 034( pesemilion e treqind e tetedhjetë e nente mijë e tridhjetë e kater ) leke per arsye se komisioni vleresimit te ofertave konstatoi keto mangesi :

Se pari i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nisur nga shtojcat sipas dst dhe formulari i ofertes ekonomike nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit Sark shpk z. Arben Kajolli por janë nënshkruar nga një person tjetër me p/perpara dhe nuk ka një dokument justifikues me të cilin të provohet se është autorizuar për të nënshkruar në emër dhe për llogari të përfaqësuesit ligjor Arben Kajolli , kjo në kundërshtim me dispozitat e nenit 95 pika 3 e Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Shoqëritë tregtare “ të ndryshuar

Se dyti në përmbushje të kriterit .”*Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

OE ka paraqitur vërtetimin nr 1388prot date 01.07.2019 të leshuar nga OSHEE ku rezulton se titullar e kontratave është z. Arben Kajolli dhe jo shoqëria Sark shpk . Pra nuk ka paraqitur dokumentin që provon se shoqëria Sark shpk ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike

Se treti nuk përmbush kriterin e kërkuar në pikën 2.3.3/a Shoqëria të këte në stafin drejtues minimumi një inxhinier ndërtimi; 1 (një) inxhinier elektrik ; të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në listepagesat e shoqërisë për 6 muajt të fundit të kërkuar nga data e hapjes së ofertave . Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontrata individuale të punës
- Diploma
- Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e leshuar nga një trup çertifikuese e akredituar në RSH-se

Në plotësim të këtij kushti këni paraqitur dokumentacion kontratave pune dhe diplome të pashoqëruar me dëshmi kualifikimi për ing Rozina Tabaku e cila nuk diguron si drejtuese teknike e shoqërisë Sark shpk

KVO gjykon se ju nuk plotësoni kriterin e mesiperm

Se katërti nuk përmbush kriterin e kërkuar në pikën 2.3.3 germa dShoqëria, përveç stafit drejtues, duhet të këte në stafin mbështes edhe minimumi , 3 specialiste elektriciste , 3 karpentier , të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për 6 muajt të fundit nga data e hapjes së ofertave .

Për secilin duhet të paraqiten:

Kontrata individuale të punës

Çertifikata e kualifikimit profesional për specialistet.

Në plotësim të këtij kriteri këni paraqitur kontratave pune për tre elektricistat Ledion Hatia , Lefter Gega dhe Almen Cuko të pashoqëruar me Çertifikatën e kualifikimit profesional

Nuk këni praqitur dokumentacionin e kërkuar për të provuar se në stafin tuaj këni të punësuar 3

karpentier

Se pesti : nuk permbush kriterin e kerkuar ne piken 2.3.3 germa “e”

- a. Shoqeria te kete punonjes te kualifikuar me Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trup çertifikuese e akredituar ne RSH-se, nder te cilet te kete minimalisht 3 specialiste elektrik ;1 teknik ndërtimi dhe 2 manovratore. Secili duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per gjashte muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave.

Per secilin duhet te paraqiten:

- Kontrate individuale e punes
- Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trup çertifikuese e akredituar ne RSH-se

Per manovratorët te paraqitet edhe deshmia e aftesise profesionale per perdoruesit e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke e leshuar nga DPSHTRR dhe leja e drejtimit ku te disponohet kategoria C.

OE ka paraqitur dokumentacion te plote vetem per nje manovrator bashkim Zenunaj

Per manovratori Taulant Xhafa nuk ka paraqitur Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik

Per manovratorin Arben Kajolli kea paraqitur vetem deshmi manovrimi te pashoqeruar me kontrate individuale dhe dhe deshmi kualifikimi

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimi i operatoreve ekonomik Drini A me nr Nipti J67902505V& Varaku shpk me nr Nipti J61902509S me vlere oferte 6 052 250 ( gjashte milion e pesedhete e dy mije e dyqinde pesedhete leke se është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [bashkise Lezhe , sektorit te prokurimeve publrike ] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ( pese )ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 23 .07.2019

Ankesa:Po

I është kthyer pergjigje me date 29.07.2019.

**KRYETARI  
FRAN FRROKAJ**

Konc:F.Dedgjonaj

Bashkia Lezhë,L. Skenderbeg , Sheshi "Gjergj Kastrioti", 4501, Lezhë, e-mail: [f.frokaj@lezha.gov.al](mailto:f.frokaj@lezha.gov.al) ,  
web:[www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)